



KUPCHAN:

PAS DËSHTIMEVE GLOBALE,
TRUMPI MUND T’U KTHEHET
KOSOVËS DHE SERBISË

FAQE 4-5



Charles Kupchan nga Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë në ShBA thotë se deklarata e fundit e presidentit amerikan Donald Trump, për Kosovën dhe Serbinë, duhet parë në kontekstin e një lideri që po përpiqet ta rikthejë

vëmendjen e opinionit publik mbi rolin e tij si “negociator i shkëlqyer”. Kupchan, ish-drejtor i çështjeve evropiane në Këshillin e Sigurisë Kombëtare të ShBA-së, në intervistën dhënë “Radio Evropa e Lirë” thotë se

kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, “mund ta ketë tepruar me përdorimin e kartës nacionaliste”. Ai i sugjeron një qasje më pragmatike që, siç thotë, do ta ndihmonte Kosovën t’i avanconte interesat e saj

PUSHTETI PERSONAL
SI SFIDË NDAJ RENDIT
KUSHTETUES: RASTI I
KRIZËS SË KONSTITUIMIT
TË KUVENDIT
TË KOSOVËS

Prof. dr. Fejzulla BERISHA



BISLIMI
INTERVIËTOHET
NJË ORË E GJYSMË
NGA PROKURORIA
SPECIALE, SULMON
MEDIET

F.3



AKTUALE



KHAMENEI S’E PRANON THIRRJEN
PËR T’U DORËZUAR, PARALAJMËRON
“DËME TË PARIPARUESHME”
NËSE SHBA-JA PËRFSHIHET

F.2

UP-ja NDERON ME TITULLIN ‘DOCTOR
HONORIS CAUSA’ PROFESORIN
JAPONEZ HISASHI OWADA

F.5

OSMANI: KOSOVA E VENDOSUR PËR
HAPJEN E KAPITUJVE TË RI TË
BASHKËPUNIMIT ME HUNGARINË

F.7

EKONOMI



KATËR SHPELLAT UNIKE TË
KOSOVËS NË PULLA POSTARE

F.8

OFROHET QASJE E LEHTË
NË KREDI BUJQËSORE PËRMES
DIGJITALIZIMIT DHE ELIMINIMIT
TË BARRIERAVE

F.8

SPORT



ADEMI: BISEDË E FRYTSHME ME
FODËN PËR TË ARDHMEN E KOSOVËS

F.10

RENOVA

PUTZ

Magedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA

NDËRTIM
PROJEKTIM

INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini

FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji
BIZNESI

www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030-500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY

Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

Khamenei s'e pranon thirrjen për t'u dorëzuar, paralajmëron "dëme të pariparueshme" nëse ShBA-ja përfshihet

TEHRAN, 18 QERSHOR - Lideri suprem i Iranit, Ajatollah Ali Khamenei, i hodhi poshtë të mërkurën thirrjet e Shteteve të Bashkuara për t'u dorëzuar përballë bombardimeve nga Izraeli dhe paralajmëroi se ShBA-ja do të pësojë "dëme të pariparueshme" nëse përfshihet ushtarakisht. Deklaratat e Khameneit u lexuan nga një spikere në televizionin shtetëror iranian. Khamenei, i cili është parë vetëm një herë prej se filluan sulmet javën e kaluar - i bëri këto komente pasi presidenti i ShBA-së, Donald Trump, kërkoi nga Irani të "dorëzohet pa kushte" dhe e paralajmëroi Khamenein se ShBA-ja e di ku ndodhet ai, por nuk ka plane ta vrasë "tani për tani". Trumpi fillimisht u distancua nga sulmi i papritur i Izraelit të premten, i cili e shkaktoi konfliktin, por ditë e fundit ka lënë të kuptohet se mund të ketë përfshirje më të madhe

amerikane, duke thënë se dëshiron "diçka shumë më të madhe" sesa thjesht një armëpushim. ShBA-ja, gjithashtu, ka dërguar më shumë avionë ushtarakë dhe luftanije në Lindjen e Mesme. Khamenei i hodhi poshtë deklaratat "kërcënuese dhe absurde" të Trumpit. "Njerëzit e mençur që e njohin Iranin, popullin e tij dhe historinë e tij, kurrë nuk i flasin këtij kombi me gjuhën e kërcënimit, sepse kombi iranian nuk është ai që dorëzohet", tha Khamenei. "Amerikanët duhet ta dinë se çdo përfshirje ushtarake nga ShBA-ja do të shkaktojë padyshim dëme të pariparueshme për ta", shtoi ai. Televizioni shtetëror tha se do ta transmetojë më vonë një video ku Khamenei shihet duke e dhënë fjalimin e tij. Irani ka vepruar njëlojtë edhe më parë kur ka lëshuar deklaratat nga lideri suprem, ndoshta për



arsye sigurie. Vendndodhja e Khameneit nuk dihet. Një zyrtar iranian më herët të mërkurën paralajmëroi se ndërhyrja e ShBA-së do të rrezikonte "luftë të gjithanshme". Zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme, Esmail Baghaei, nuk dha hollësi, por mijëra trupa amerikane janë të vendosura në vende përreth që janë brenda rrezes së armëve

iraniane. ShBA-ja ka kërcënuar me përgjigje të fuqishme ndaj çdo sulmi. Një zyrtar tjetër iranian tha se vendi do ta vazhdojë pasurimin e uraniumit për qëllime paqësore, duke lënë të kuptohet se kërkesat e Trumpit që Irani të heqë dorë nga programi bërthamor janë të papranueshme.

Izraeli i nisi bombardimet ndaj Iranit të premten e kaluar dhe të mërkurën ushtria izraelite tha se ka kryer sulme në Iranin perëndimor, duke goditur depo raketore dhe një raketahedhës të mbushur. Izraeli i ka goditur disa objekte bërthamore dhe ushtarake, duke vrarë gjeneralë të lartë dhe shkencëtarë bërthamorë. Një grup për të drejtat e njeriut me seli në Uashington tha se të paktën 585 njerëz, përfshirë 239 civilë, janë vrarë dhe mbi 1 300 janë plagosur në Iran. Irani i ka lëshuar rreth 400 raketa dhe qindra dronë në sulme hakmarrëse ndaj Izraelit, duke i vrarë të paktën 24 njerëz dhe duke plagosur qindra të tjerë. Disa raketa kanë goditur ndërtesa banimi në Izraelin qendror, duke shkaktuar dëme të mëdha, dhe sirenat e sulmeve ajrore i kanë detyruar izraelitët të strehohen disa herë.

Merz: Izraeli po kryen 'punën e ndyrë për të gjithë ne'

BERLIN, 18 QERSHOR - Kancelari gjerman Friedrich Merz ka shprehur mbështetje të fuqishme për Izraelin dhe fushatën e tij ushtarake kundër Iranit teksa ka folur për mediet gjermane në margjina të samitit të shtatë shteteve më të industrializuara (G7) që këtë vit po mbahet në Kanada. "Kjo është puna e ndyrë që Izraeli po e bën për të gjithë ne", ka thënë Merz në një intervistë për transmetuesin ZDF. "Edhe ne jemi viktimë të këtij regjimi. Ky regjim i mullahëve i ka sjellë botës vdekje dhe shkatërrim", ka thënë ai. Merz ka sugjeruar, gjithashtu, se sulmet izraelite në Iran mund të çojnë në rrëzimin e udhëheqësisë së Republikës Islamike. "Besoj se sulmet e



ditëve të fundit e kanë dobësuar regjimin e mullahëve dhe nuk shoh që do të mund t'i kthehen forcës së dikurshme, duke e bërë të ardhmen e shtetit më të

paqartë", ka thënë Merz. "Për të qenë i sigurt, e kam vështirë të imagjinoj se regjimi i mullahëve do t'u kthehet funksioneve të vjetra. Figura të

mëdha të udhëheqësisë ushtarake dhe Gardës Revolucionare Islamike nuk janë më gjallë dhe gjërat nuk do të jenë siç ishin". I pyetur nëse beson që Shtetet e Bashkuara do të përfshihen në fushatën ushtarake kundër Iranit, Merz ka thënë se beson që "nuk ka vendim ende nga qeveria amerikane". "Tani varet se sa do të jetë gati regjimi i mullahëve për t'u kthyer në tavolinën e negociatave. Nëse jo, atëherë mund të ketë zhvillime të këtij lloji", ka thënë ai. Izraeli ka nisur të premten fushatë ajrore duke goditur qendra ushtarake dhe bërthamore brenda Iranit, duke thënë se synon t'ia pamundësojë armikut të tij posedimin e armëve

bërthamore. Mirëpo kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu ka sugjeruar se fushata ushtarake mund të ketë edhe qëllime të tjera. Ai ka thënë një ditë më parë se Izraeli "është duke ndryshuar fytyrën e Lindjes së Mesme" me këtë fushatë, e cila mund të rezultojë me "ndryshime radikale" brenda shtetit. Irani udhëhiqet prej liderëve klerikë prej Revolucionit Islamik të vitit 1979 dhe është akuzuar nga Perëndimi për abuzime me të drejta të njeriut dhe shtypje brutale të disidentëve. Liderët e grupit G7 kanë bërë thirrje të hënën për shtensionim në Lindje të Mesme, duke theksuar se Izraeli "ka të drejtë ta mbrojtë veten" dhe që civilët duhen mbrojtur në të dyja anët.

Kallas: Rusia s'ka shanse nëse NATO-ja qëndron e bashkuar

BRUKSEL, 18 QERSHOR - Shefja e diplomacisë e Bashkimit Evropian, Kaja Kallas, tha se Rusia "s'ka shanse" kundër NATO-s, por aleanca duhet "të qëndrojë e bashkuar" përballë një Moske armiqësore. Duke folur para mbajtjes së samitit të NATO në Holandë, ku anëtarët e aleancës janë në presion nga Shtetet e Bashkuara për t'i rritur shpenzimet për mbrojtje,

Kallasi paralajmëroi se vetëm rritja e shpenzimeve për mbrojtje nuk mjafton për ta frenuar Kremlinin. "Sot, kundër NATO-s dhe BE-së, Rusia s'ka shanse, por ne duhet të qëndrojmë të bashkuar", tha Kallas para Parlamentit Evropian në Strasburg. "Kur udhëheqësit e NATO-s të takohen javën e ardhshme, mbajtja e unitetit në aleancë është prioritet më i madh sesa

rritja e shpenzimeve për mbrojtje", shtoi kryediplomatja evropiane. Udhëheqësit e NATO-s po synojnë të arrijnë pajtim për rritjen e buxheteve për ushtritë kur të takohen në Hagë javën e ardhshme. Por, aleanca - ku nga 27 vendet anëtare, 23 prej tyre janë shtete të BE-së - po përballlet me dilema sa i përket përkushtimit të ShBA-së ndaj mbrojtjes së Evropës.



BISLIMI INTERVISTOHET NJË ORË E GJYSMË NGA PROKURORIA SPECIALE, SULMON MEDIET

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Zëvendëskryeministri në detyrë i Kosovës, Besnik Bislimi, është intervistuar nga Prokuroria Speciale e Kosovës për rastin që ka të bëjë me hetimet mbi dyshimet për dhënien me qira të fabrikës për mbetje shtazore. Bislimi është intervistuar në cilësinë e dëshmitarit, konfirmoi Prokuroria Speciale e Kosovës. Ai është intervistuar mëngjesin e së mërkurës për rreth një orë e gjysmë dhe më pas Bislimi tha se atij prokurorët nuk i parashtruan asnjë pyetje “që mund të cilësohet si pyetje drejtuar një dëshmitari”. “Sot isha në prokurori i ftuar në cilësinë e dëshmitarit në hetimet e prokurorisë rreth funksionalizimit të fabrikës për nënproduktet shtazore në Drenas. Intervista zgjati diku 1 orë e 30 minuta dhe përgjatë kësaj kohe nuk kishte asnjë pyetje që mund të cilësohet si pyetje drejtuar një dëshmitari.

Po ashtu arrita të konfirmoj që të gjitha informacionet që prezantova sot kanë mund të grumbullohen shumë lehtë pa patur nevojë fare për intervistim. Do të kishte mjaftuar një studim minimal për detyrat dhe përgjegjësitë e zëvendëskryeministrit brenda portfolios së integriteteve evropiane dhe një shfletim i shpejtë i raporteve për vendin ndër vite nga Komisioni Evropian”, ka shkruar ai në “Facebook”.

Ai ka thënë se nisur nga fakti se hyrja e ndërtesës ku u mbajt intervista ishte vërshuar nga mediet gjë që, sipas tij, nuk ndodh në raste të tjera kur ftohen dëshmitarët. “Dhe nga përvoja e nxjerrjes në media të lajmit për intervistim saktësisht kur po zhvillohej takimi trilateral i dialogut në Bruksel, del i pashmangshëm përfundimi se qëllimi parësor i kësaj interviste ka qenë prodhimi i lajmit medial, ku eksponentë të qeverisë bëhen pjesë e titujve bashkë me

termin ‘skandal’. ‘Skandal’ që origjinën nuk e ka as në ministri të linjës e as në prokurori, por te eksponentë të medias. Kjo e vendosë prokurorinë në një perspektivë jashtëzakonisht negative karshi përgjegjëseve që ka dhe orientimit që ka zgjedhur të ndjekë. Do të ishte me interes të shumëfishtë që kjo qasje të rishikohet”, ka shkruar Bislimi.

Ndërkaq nga Prokuroria Speciale thanë se hetimet lidhur me dyshimet për dhënien me qira të fabrikës për përpunimin e produkteve nënshtazore janë në fazën fillestare, prandaj nuk mund të japin tani për tani hollësi lidhur me intervistimin e Bislimit. Për këtë rast, për disa orë më 27 maj ishte intervistuar edhe ministri në detyrë i Bujqësisë, Faton Peci, por edhe kryeshefi i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, Bekim Hoxha, që të dy në cilësinë e të dyshuarit. Peci dhe Hoxha u intervistuan pasi autoritetet paraprakisht po më 27 maj kryen bastisje në

Ministrinë e Bujqësisë, Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, Agjencinë e Veterinarisë, si dhe në lokacionin e kompanisë përfituese.

Për cilën fabrikë bëhet fjalë?

Në Parkun Industrial në Drenas dhjetorin e vitit 2019 kishte përfunduar ndërtimi i fabrikës ku parashihej të përpunoheshin dhe asgjësoheshin nënproduktet shtazore. Por, funksionalizimi i fabrikës - ndërtimi i së cilës kushtoi 7.7 milionë euro - nisi më 2024, kur u hap thirrja për kompanitë që të aplikonin për marrjen në shfrytëzim të saj dhe për ta nisur punën për grumbullimin dhe kategorizimin e nënprodukteve shtazore.

U raportua se kompania e Kosovës LIP KS & IT ShPK. u përzgjedh për ta funksionalizuar fabrikën, me afat operimi për 20 vjet,

përkatësisht deri më 2044. U tha se kjo kompani ishte regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) vetëm pesë ditë pas thirrjes për aplikim. Kësajsoj dyshohet se nuk u përmbushën kriteret që fituesi i kontratës të kishte përvojë 12 deri në 15-vjeçare për përpunimin e nënprodukteve shtazore dhe të dëshmonte se në tre vjetët e fundit kishte përpunuar 20 mijë tonë të nënprodukteve shtazore.

Një ditë para kryerjes së bastisjeve në Ministrinë e Bujqësisë, Partia Demokratike e Kosovës deklaroi se ministri në detyrë, Peci, pa ankand publik ia ka dhënë me qira pronën për fabrikën për mbetjet shtazore një kompanie për 20 vjet. PDK-ja tha se Ministria e Bujqësisë ka shkëlur Ligjin për Pronën Publike, që tha se parasheh që pronat publike të jepen me qira vetëm përmes ankandit publik dhe jo më shumë se 15 vjet, përveç në rastet kur merret vendim në Kuvendin e Kosovës.

Maqedonci me komandantin e KFOR-it bisedojnë rreth situatës së sigurisë

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Ministri në detyrë i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka pritur në takim komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Enrico Banduani, me të cilin kanë diskutuar rreth situatës së sigurisë në nivel regional dhe global. Të dy

bashkëbiseduesit e vlerësuan të rëndësishme pjesëmarrjen e FSK-së në kuadër të ushtrimit ndërinstitucional ndërmjet FSK-së, KFOR-it dhe Policisë, “Golden Sabre 25”, organizuar nga misioni i NATO-s në Kosovë, gjë që ka ndikuar në thellimin e bashkëpunimit ndërmjet

Ministrit të Mbrojtjes dhe KFOR-it. Me këtë rast ministri Maqedonci shprehi gatishmërinë për vazhdimin e koordinimit të ndërsjellë për çështjet me interes të përbashkët në kuadër të zhvillimeve aktuale dhe ndikimit të tyre në mjedisin e sigurisë.





KUPCHAN: PAS DËSHTIMEVE GLOBALE, TRUMPI MUND T’U KTHEHET KOSOVËS DHE SERBISË

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Charles Kupchan, nga Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë në ShBA, thotë se deklarata e fundit e presidentit amerikan Donald Trump për Kosovën dhe Serbinë duhet parë në kontekstin e një lideri që po përpiqet ta rikthejë vëmendjen e opinionit publik mbi rolin e tij si “negociator i shkëlqyer”. Sipas tij, premtimet e Trumpit për t’i dhënë fund luftës në Ukrainë dhe konfliktit në Lindjen e Mesme nuk janë pasqyruar në realitet, pasi luftërat vazhdojnë me intensitet dhe aktorët kryesorë nuk tregojnë shenja gatishmërie për kompromis. “Thënë kjo, meqë nuk po arrin shumë rezultate në Lindjen e Mesme dhe në diplomacinë me Ukrainën dhe Rusinë, ai mund ta kthejë vëmendjen nga Kosova dhe Serbia dhe të përpiqet të arrijë ndonjë fitore”, thotë Kupchan në intervistën dhënë Radio Evropa e Lirë. Kupchan, ish-drejtor i çështjeve evropiane në Këshillin e Sigurisë Kombëtare të ShBA-së, thotë se kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, “mund ta ketë tepruar me përdorimin e kartës nacionaliste”. Ai i sugjeron një qasje më pragmatike që, siç thotë, do ta ndihmonte Kosovën t’i avanconte interesat e saj.

Presidenti Trump tha së voni se ai

ka ndaluar një luftë në mes të Kosovës dhe Serbisë gjatë mandatit të parë presidencial dhe ka premtuar se “do ta rregullojë këtë sërish”. Sipas jush, sa e saktë është kjo deklaratë dhe çfarë ndikimi kishin përpjekjet diplomatike të ShBA-së në vitin 2020 në terren?

Charles Kupchan: Mendoj se postimin e Trumpit duhet parë në kontekstin e një presidenti që ndien se pretendimet e tij se është negociator i shkëlqyer, po vihen në dyshim. Ai ka thënë se do t’i japë fund luftës në Ukrainë për 24 orë dhe se do ta ndalë luftën në Lindjen e Mesme, ndërkohë që lufta në Ukrainë vazhdon me intensitet, [presidenti rus, Vladimir] Putin nuk jep asnjë shenjë se është i gatshëm të negociojë me mirëbesim, ndërsa Izraeli jo vetëm që vazhdon luftën kundër Hamasit në Gazë, por ka hapur edhe një front të ri me Iranin. Ndaj, mendoj se Trump po përpiqet të rikujtonte opinionin publik për arritjet e tij të mëparshme. Por, edhe në këtë rast, ku përmendi Kosovën dhe Serbinë, ai, kryesisht, i ngatërroi faktet, sepse Kosova dhe Serbia nuk ishin në luftë - ato nuk ishin në luftë që nga viti 1999. A pati sukses administrata Trump, me [të dërguarin për dialogun Kosovë-Serbi, Richard] Grenell, në avancimin e një

marrëveshjeje për bashkëpunim ekonomik mes Kosovës dhe Serbisë? Po. A arritën ata të ndërmjetësojnë një marrëveshje që Kosova të krijojë marrëdhënie diplomatike me Izraelin? Po. Këto nuk janë të parëndësishme. Por, ideja se Trump - në njëfarë mënyre - ka shmangur ose i ka dhënë fund luftës, është thjesht e pasaktë.

Marrë parasysht atë që sapo thatë edhe ju - se Trump, deri më tani, nuk ka arritur ndonjë sukses në zgjidhjen e konfliktit Rusi - Ukrainë dhe tani përballet edhe me tensione midis Izraelit dhe Iranit - a shihni ndonjë mundësi që ai të kthehet te procesi Kosovë - Serbi, si një fushë më e menaxhueshme e politikës së jashtme?

Charles Kupchan: Po, mendoj se kjo nuk përjashtohet fare. Trump, tani, ka shumë punë. Ka luftën e madhe në Ukrainë, luftën e madhe në Lindjen e Mesme, ka 17 apo 18 palë negociata të ndryshme për tarifa dhe tregti që vazhdojnë, dhe situata e tij politike brenda vendit është e ndërlikuar, veçanërisht për çështjet e imigracionit dhe dëbimeve. Kemi parë, po ashtu, dhunë në rrugët e Los Anxhelosit dhe sulme ndaj ligjvënësve në Minesotë. Ndaj, nuk mendoj se Trump apo ekipi i tij kanë shumë kapacitete tani për çështje të

tjera. Thënë kjo, meqë nuk po arrin shumë rezultate në Lindjen e Mesme dhe në diplomacinë me Ukrainën dhe Rusinë, ai mund ta kthejë vëmendjen nga Kosova dhe Serbia dhe të përpiqet të arrijë ndonjë fitore. A është momenti i duhur për këtë? Me gjasë jo. Sepse situata politike është e paqëndrueshme si në Beograd, ashtu edhe në Prishtinë. Tani për tani, askush nuk është në pozicion për të bërë kompromise të vështira, por mendoj se në kohën e duhur, Trump mund të rikthehet për të negociuar një marrëveshje dhe për t’i nxitur Serbinë dhe Kosovën që të ecin përpara me marrëveshjen që ndërmjetësoi Bashkimi Evropian.

Si do të dukej riangazhimi i tij në mosmarrëveshjen në mes të Kosovës dhe Serbisë?

Charles Kupchan: Riangazhimi [do të pasqyrohej] me emërimin e Richard Grenellit apo ndonjë përfaqësuesi tjetër special, i cili ose e cila do t’i shpërvilte mëngët dhe do të shkonte në rajon, do të takohej me udhëheqësit atje dhe do të përpiqej t’i shtynte të dyja vendet në drejtim të zbatimit të Marrëveshjes [drejt normalizimit të marrëdhënieve]. Viteve të fundit, zbatimi ka ngecur thuajse plotësisht. Për këtë arsye, mendoj se do të nevojitet një angazhim i ri nga

ShBA-ja dhe presion i ri nga ShBA-ja, në bashkëpunim me BE-në, për të rifilluar dialogun.

“Kurti mund ta ketë tepruar me kartën nacionaliste”

Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, i është përgjigjur deklaratës së Trumpit, duke thënë se normalizimi i marrëdhënieve është i mundur, por vetëm nëse ShBA-ja dhe të tjerët e rrisin presionin mbi Serbinë për t’i zbatuar marrëveshjet e arritura në vitin 2023. A mendoni se Uashingtoni duhet ta ndryshojë qasjen dhe të ushtrojë presion më të drejtpërdrejtë mbi Beogradin?

Charles Kupchan: Mendoj se ShBA-ja dhe BE-ja duhet të bëjnë shumë presion ndaj të dyja palëve. Një nga zhvillimet më pak pozitive për Kosovën gjatë viteve të fundit, sipas mendimit tim, është se kryeministri Kurti mund ta ketë tepruar me përdorimin e kartës nacionaliste. Ai ka ndërmarrë disa hapa [për shtrirjen e autoritetit] në veri, ka hezituuar të ndërmarrë hapa për krijimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe, ka bërë edhe veprime të tjera që, në disa aspekte, kanë bërë që Prishtina të duket si problemi, e jo Beogradi. Prandaj, kemi parë sanksione nga Bashkimi Evropian dhe kritika të forta nga

KOSOVA PËRBALLË RENDIT TË RI GLOBAL!



Ethem ÇEKU

Rendi ndërkombëtar po përjeton një transformim të thellë. Lufta në Ukrainë, përshkallëzimi i tensioneve në Lindjen e Mesme, polarizimi ShBA - Kinë dhe ringjallja e ambicieve gjeopolitike të Rusisë po i japin formë një epoqe të re, ku balancat tradicionale të fuqisë po zëvendësohen me një shumësi aktorësh të etur për ndikim global.

Këto zhvillime nuk përbëjnë vetëm sfida për sigurinë ndërkombëtare, por po imponojnë edhe nevojën për përshtatje të shpejtë strategjike të shtetave të vogla, si Kosova. Në këtë kontekst global të paqëndrueshëm, Kosova mbetet e ekspozuar ndaj sfidave të shumta: mungesa e konsolidimit të brendshëm institucional, polarizimi i skajshëm politik, tensionet me Serbinë dhe mungesa e progresit në dialogun ndërkombëtar. Mbi të gjitha, kriza e vazhdueshme e legjitimitetit dhe mungesa e një qasjeje të përbashkët strategjike e kanë bërë Kosovën më të brishtë në raport me zhvillimet rajonale dhe globale. Në vend të një reflektimi të

thelluar institucional, skena politike kosovare është dominuar nga konfliktualiteti, retorika ndarëse dhe mungesa e një vizioni të qartë kombëtar. Në një botë ku siguria, zhvillimi ekonomik dhe aleancat ndërkombëtare kërkojnë përgjegjësi të lartë shtetërore, Kosova nuk mund të lejojë luksin e përçarjes. Në këtë situatë, nevoja për një konsensus politik dhe strategjik bëhet imperative. Konsensusi nuk nënkupton homogjenitet ideologjik, por ndërtimin e një platforme të përbashkët kombëtare mbi çështjet kyçe: sigurinë, dialogun ndërkombëtar, zhvillimin ekonomik dhe orientimin euroatlantik të vendit. Pa një qasje gjithëpërfshirëse, nuk mund të ketë as stabilitet të

brendshëm, as integrim ndërkombëtar të suksesshëm. Roli i Shqipërisë, në këtë drejtim, mbetet thelbësor. Si anëtare e NATO-s dhe kandidatë për anëtarësim në Bashkimin Evropian, Shqipëria ka përgjegjësinë historike për të ndihmuar në kapërcimin e ngërçit politik në Kosovë. Përmes diplomacisë së qetë, koordinimit të politikave dhe ndërtimit të projekteve të përbashkëta zhvillimore, Shqipëria mund të kontribuojë në krijimin e një arkitekture të re të stabilitetit institucional dhe ekonomik në Kosovë. Marrëdhëniet strategjike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Turqinë duhet të thellohen në mënyrë pragmatike dhe afatgjatë.

ShBA-ja mbetet faktori kryesor i sigurisë dhe pavarësisë së Kosovës, ndërsa Turqia ofron mundësi konkrete për bashkëpunim ekonomik, teknologjik dhe infrastrukturor. Në vend të orientimeve të paqarta, Kosova duhet të zhvillojë një diplomaci të qëndrueshme që harmonizon interesin kombëtar me rrethanat ndërkombëtare. Në fund, në një botë gjithnjë e më multipolare, Kosova ka dy mundësi: ose të mbetet peng i krizës së brendshme dhe i moskoordinimit strategjik, ose të ngrihet në lartësinë e përgjegjësi historike dhe të ndërtojë një model të ri të qeverisjes kombëtare, të bazuar në unitet, profesionalizëm dhe partneritet ndërkombëtar.

UP-ja NDERON ME TITULLIN ‘DOCTOR HONORIS CAUSA’ PROFESORIN JAPONEZ HISASHI OWADA

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Në ceremoninë solemne të mbajtur në Amfiteatrin e Fakultetit të Edukimit, Universiteti i Prishtinës i akordoi titullin e lartë “Doctor Honoris Causa” profesorit Hisashi Owada për kontributin e jashtëzakonshëm akademik si dhe angazhimin jetësor në fushën e drejtësisë ndërkombëtare dhe promovimin e paqes globale. Laudator i këtij nderimi ishte dekan i Fakultetit Juridik, prof. Avni Puka, ndërsa rektori, prof. Arben Hajrullahu, e cilësoi profesor Owadan qytetar i botës, shembull i vlerave universale të drejtësisë dhe



dinjitetit njerëzor. Profesor Owada në fjalën e tij para të pranishmëve falënderoi Universitetin e Prishtinës për nderimin që i bëri, bashkë me të gjithë personat që

kontribuan në këtë proces. Në këtë ngjarje të shënuar për Universitetin e Prishtinës morën pjesë ambasadori i Japonisë në Austri e Kosovë, Kiminori Iwama, i ngarkuari me

punë i Ambasadës së Japonisë në Kosovë, Hiroyasu Tanigaki, ambasadori i Republikës së Kosovës në Japoni, Sabri Kiçmari, ambasadorë dhe përfaqësues të shteteve të ndryshme, organizatave të tjera ndërkombëtare dhe partnere të UP-së. Pritja e mysafirëve të nderuar u bë nga rektori Arben Hajrullahu dhe prorektorët Rozafa Basha, Albana Berisha-Qehaja, Majlinda Gjellaj, Naim Jerliu e Avni Hajdari, ndërsa të pranishëm gjatë nderimit të profesor Owada ishin edhe kryesuesi dhe anëtarët e Këshillit Drejtues, dekanët dhe prodekanët e njësive akademike

bashkë me profesorët dhe studentët e UP-së, rektorët e universiteteve publike të vendit dhe figura të shquara të jetës dhe institucioneve akademike të Kosovës e më gjerë. Profesor Hisashi Owada dha mësim në universitetet e Tokios dhe Wasedas në Japoni dhe në universitetet amerikane të Harvardit, Columbias e New Yorkut. Doktor i Nderit i UP-së ka lidhje të ngushta edhe me familjen perandorake japoneze, pasi vajza e tij është e martuar me perandorin japonez Naruhito. Gjatë ceremonisë studentët dhe profesorët e Fakultetit të Arteve ekzekutuan disa pika artistike.

Uashingtoni gjatë administratës Biden. Mendoj se dialogu është në ngërc dhe do të nevojitet presion i konsiderueshëm mbi të dyja palët për ta shtyrë përpara.

Kurti më parë ka paraqitur tri kërkesa për normalizimin e marrëdhënieve: dorëzimin e Millan Radoičiqit nga Serbia, nënshkrimin formal të Marrëveshjes Bazë me Aneksin e Zbatimit, dhe tërheqjen e letërës së dhjetorit 2023 që refuzonte integritetin territorial të Kosovës. Sa realiste dhe efektive i konsideroni këto kërkesa?

Charles Kupchan: Mendoj se dialogu duhet të ecë përpara në faza, hap pas hapi. BE-ja veprimi drejt kur ndërmjetësoi marrëveshjen nga kërkuar menjëherë që Serbia ta njohë Kosovën si shtet të pavarur. Mendoj se e dimë që, në fund, kjo çështje do të përfundojë me njohjen e Kosovës si shtet i pavarur nga Serbia, por, paraprakisht, secila palë duhet t'i bëjë hapat e nevojshëm, për të treguar vullnet të mirë dhe për të ecur përpara drejt normalizimit të marrëdhënieve mes tyre. Qeveria e Serbisë e di se, në fund, nuk do të hyjë në Bashkimin Evropian pa e njohur Kosovën. Prandaj, çështja tani është se si të

krijohet një terren i ri politik, që u jep udhëheqësve në Prishtinë dhe në Beograd guximin dhe mbështetjen e nevojshme për të marrë vendime të vështira - edhe nëse ato nuk janë të pëlqyera në opinionin publik.

Kurti, po ashtu, ka thënë se ShBA-ja mbetet “partnere e pazëvendësueshme” e Kosovës në mbrojtje, diplomaci dhe zhvillim. Mendoni se Kosova mund të vazhdojë të mbështetet në përkrahjen e fuqishme amerikane, në një kohë kur po ndodhin ripozicionime globale dhe politika e jashtme e Trumpit është më transaksionale?

Charles Kupchan: Në Shtetet e Bashkuara ekziston një mirëbesim i madh ndaj Kosovës, që nga ndërhyrja e NATO-s në vitin 1999 dhe përpjekjet që janë bërë prej atëherë për ta ndihmuar Kosovën të zhvillohet si një demokraci e suksesshme. A mendoj se gjatë presidencës së Trumpit do të shohim më pak fokus tek Evropa dhe më shumë tek Indo-Paqësori? Po, ka shumë gjasa. Mendoj se Trump e ka bërë të qartë se dëshiron që Evropa të shpenzojë më shumë për mbrojtjen dhe të marrë më shumë përgjegjësi për zgjidhjen e sfidave në fqinjësinë e saj.

A pres që Trump të tërhiqet krejtësisht nga Evropa? A mendoj se pas katër vjetësh nuk do të ketë më trupa amerikane në Evropë? Jo, nuk e besoj. Mendoj se ajo që do të shohim, do të jetë një riekulibrim i pranisë, por jo tërheqje. Dhe, në këtë drejtim, mendoj se Kosova duhet të presë politika të mira dhe një angazhim pozitiv nga Uashingtoni. Ndaj, është në interes të Kosovës dhe të kryeministrit Kurti që të ndjekë politika më mbështetëse për procesin e dialogut.

“Marrëveshja e Ohrit është e mirë - duhen kompromise”

Duke pasur parasysh përvojën tuaj të gjatë në çështjet evropiane, si do të dukej një plan real për normalizimin e qëndrueshëm të marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë?

Charles Kupchan: Mendoj se Marrëveshja e Ohrit, e ndërmjetësuar nga BE-ja, është e mirë. Tani, sipas mendimit tim, më shumë bëhet fjalë për zbatimin, sesa për drejtimin që do të marrë procesi më tej. Në përgjithësi, kur shikoni konflikte të zgjatura si ky, ku të dyja palët janë të ngulitura në pozicionet e tyre, rruga përpara

është me hapa të vegjël e gradualë, që tregojnë vullnet të mirë. Secila palë duhet të bëjë kompromise dhe lëshime që i japin sinjal palës tjetër se dëshiron të bashkëpunojë dhe të avancojë drejt kthimit të armiqve në miq. Prandaj, mendoj se hapi i ardhshëm duhet të përfshijë një plan pune të detajuar me hapa konkretë. Çfarë do të bëjë Kosova? Çfarë do të bëjë Serbia? Kur do ta bëjnë? Cilët janë hapat që do të ndërmerren për ta çuar Prishtinën dhe Beogradin drejt një marrëveshjeje më të mirë, e cila në fund do të mundësojë normalizimin e marrëdhënieve dhe njohjen e Kosovës si shtet i pavarur...

Çfarë mund të bëjë ShBA-ja për t'i rikthyer palët në tryezën e bisedimeve?

Charles Kupchan: Nën një, ShBA-ja duhet të shfaqet. Duhet të angazhohet. Duhet që diplomatët e saj në rajon të jenë aktivë dhe të punojnë në këtë çështje. Nën dy, mendoj se duhet një kombinim i duhur i 'karotave dhe shkopinjve'. Shkopinj për t'u thënë: nëse vonoheni me veprime, nëse bëni gjëra provokuese, atëherë do ta

paguani çmimin. Karota për t'u thënë se drita në fund të tunelit ndriçon fuqishëm, dhe ajo dritë tregon se nëse merrni vendime të vështira dhe bëni kompromiset e nevojshme, do të përfundoni plotësisht të integruar në institucionet evropiane dhe atlantike.

Dhe një pyetje, edhe pse për çështje të brendshme... Kosova nuk i ka formuar ende institucionet e saj që pas zgjedhjeve të shkurtit. Çfarë kështille do t'u jepnit politikanëve të Kosovës?

Charles Kupchan: Nga sa kuptoj unë, pengesa kryesore tani ka të bëjë me kryetarin e Kuvendit, me një person të caktuar. Edhe pse Kuvendi është mbledhur disa dhjetëra herë, ai nuk ka arritur të marrë vendim. Dhe, e dini, përbërësi i posaçëm i demokracisë është kompromisi, është dialogu - është ai që e bën demokracinë të funksionojë. Ndaj, do të inkurajoja Kurtin dhe aleatët e tij politikë, si dhe opozitën, që të pranojnë se nuk mund të vazhdojnë pa qeveri, sepse situata është serioze. Të ulen së bashku dhe të gjejnë një kompromis për të formuar qeverinë dhe për të rifilluar punën në Prishtinë.

PUSHTETI PERSONAL SI SFIDË NDAJ RENDIT KUSHTETUES: RASTI I KRIZËS SË KONSTITUIMIT TË KUVENDIT TË KOSOVËS

Prof. dr. Fejzulla
BERISHA

I. Konteksti i përgjithshëm politik pas zgjedhjeve të 9 shkurtit 2025

Zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025 në Kosovë prodhuan një rezultat që në letër duhej të ishte shenjë e stabilitetit politik: një subjekt fitoi bindshëm shumicën relative të mandateve në Kuvend, me një përqindje të lartë të votës popullore. Megjithatë, ajo që pasoi nuk ishte konstituimi i shpejtë i institucioneve, por një krizë e re dhe e thelluar e funksionimit demokratik. Kuvendi i Kosovës, institucioni më i lartë përfaqësues i popullit dhe themeli i rendit kushtetues parlamentar, nuk arriti të konstituohej në afatet kushtetuese dhe politike. Në vend të një procesi të natyrshëm për zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit, formimin e qeverisë dhe fillimin e punës së rregullt legislative, qytetarët u përballën me një situatë të ngrirjes institucionale, shoqëruar me tensione politike, diskurse përçarëse dhe polarizim të thellë ndërmjet liderëve dhe partive. Ky realitet politik nuk është vetëm dështim i menaxhimit të një procesi kushtetues formal; ai është pasojë direkte e një kulture të rrënjësor të pushtetit personal, ku interesat individuale dhe ambiciet për kontroll total zëvendësojnë përgjegjësinë për shtetin dhe respektin për Kushtetutën.

II. Simptomat e pushtetit personal në krizën aktuale

1. Identifikimi i shtetit me liderin

Një nga shenjat më shqetësuese në sjelljen politike pas zgjedhjeve është tendenca për të identifikuar legjitimitetin shtetëror me një individ apo një qendër të vetme vendimmarrjeje. Subjekti politik fitues, në vend se të reflektojë mbi përgjegjësinë që rrjedh nga fitorja elektorale, ka kërkuar dominimin total të institucioneve - pa asnjë kompromis, pa ndarje pushteti, pa përfshirje të faktorëve tjerë politikë institucionale. Ky veprim nuk është thjesht strategji politike; është përfaqësim i një koncepti



autoritar të qeverisjes ku legjitimiteti i përkohshëm zgjedhor interpretohet si autorizim për të përjashtuar të gjithë të tjerët nga skena politike.

2. Bllokimi i Kuvendit si akt i vullnetshëm

Mungesa e gatishmërisë për kompromis rreth emërimit të kryetarit të Kuvendit, refuzimi për të ndarë pozitat drejtuese me aleatë të mundshëm ose subjekte të tjera parlamentare, si dhe përpjekjet për të detyruar bindjen e të gjithë spektrit politik përmes presionit publik e moralizues, janë tregues të qartë se konstituimi i Kuvendit nuk është pengesë teknike apo ligjore, por vullnet politike për bllokim. Ky bllokim është i qëllimshëm: ai ka për qëllim ose imponimin e një vullneti të vetëm, ose krijimin e një realiteti ku çdo akt institucional legjitim duhet të kalojë përmes filtrit të liderit që ushtron pushtet personal.

3. Injorimi i frymës dhe shkronjës së Kushtetutës

Në këtë krizë, Kushtetuta është trajtuar më shumë si një mjet për interpretim selektiv sesa si bazë e rendit demokratik. Rregullat për konstituimin e Kuvendit, procedurat për zgjedhjen e kryetarit, afatet kohore dhe domosdoshmëria për funksionalitet institucional

janë relativizuar, ndërkohë që pushteti personal i një lideri ose grupi të ngushtë vendimmarrës është vendosur mbi to. Ky përbën një rrezik të madh për demokracinë: nëse rendi kushtetues varet nga vullneti i individëve dhe jo nga zbatimi i normave, atëherë ai është gjithnjë i cenueshëm dhe i përkohshëm.

III. Pasojat e krizës: institucionalizim i anomalisë politike

1. Erozioni i besimit qytetar Qytetarët e Kosovës kanë ndjekur me zhgënjim përplasjet për pushtet që kanë mbajtur peng Kuvendin. Një pjesëmarrje e madhe në zgjedhje, e udhëhequr nga shpresa për ndryshim dhe stabilitet, është përballur me një realitet ku vota është interpretuar si mandat për përçarje dhe konflikt institucional. Besimi në demokracinë përfaqësuese dobësohet çdo ditë që institucionet nuk funksionojnë.

2. Diskreditimi i institucioneve si të tilla

Kur përplasjet për pushtet shndërrohen në betejë personale dhe institucionet mbeten peng i interesave individuale, atëherë vetë Kuvendi si institucion humb

kredibilitetin e tij. Ai nuk shihet më si vend për përfaqësim të interesit publik, por si arenë e përplasjeve të klaneve dhe individëve.

3. Rreziku për precedent kushtetues

Nëse praktikatat e bllokimit institucional legjitimohet si normë politike, atëherë shteti rrezikon të futet në një cikël krizash të përhershme, ku çdo shumicë e re e ardhshme do të ndjekë të njëjtën logjikë: ose kontroll total, ose sabotim. Kjo është rruga drejt de-institucionalizimit të demokracisë.

IV. Çfarë duhet bërë: kthimi te ligjshmëria dhe ndërtimi i etikës politike

Kriza aktuale nuk mund të tejkalohet vetëm me presion ndërkombëtar apo interpretime të njëanshme të rregulloreve. Kjo është një krizë e mendësisë politike, dhe kërkon një transformim të qasjes ndaj pushtetit dhe institucioneve. Disa hapa esenciale janë: Rikthimi i respektit për Kushtetutën si bazë e rendit demokratik, dhe jo si instrument i lojës politike; Rikthimi i Kuvendit si institucion gjithëpërfshirës, që përfaqëson pluralizmin politik dhe shoqëror, jo si

monopol i një force të vetme; Krijimi i një etike të re politike, ku pushteti nuk shihet si pronë personale, por si përgjegjësi e përbashkët ndaj qytetarëve; Reformimi i kulturës politike, ku kompromisi dhe bashkëpunimi nuk interpretohen si dobësi, por si vlera demokratike.

Ndërmjet shtetit dhe individit, zgjedhja që duhet bërë

Kriza e konstituimit të Kuvendit të Kosovës është më shumë se një ngërç politik. Ajo është një dilemë ekzistenciale për vetë shtetin e Kosovës: a do të jetë ai i ndërtuar mbi themelet e rendit kushtetues dhe të institucioneve të forta, apo do të bjerë pre e pushteteve personale që e shohin veten mbi ligjin? Historia politike e Kosovës ka treguar se shteti është arritur me shumë sakrificë dhe vështirësi. Pikërisht për këtë arsye, ai nuk duhet të bëhet peng i ambicieve personale. Përkundrazi, është koha për një kontraktim të ri politik, ku Kushtetuta, institucionet dhe qytetari janë në qendër - jo individ që kërkon të jetë më i madh se shteti.

Osmani: Kosova e vendosur për hapjen e kapitujve të ri të bashkëpunimit me Hungarinë

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, gjatë një vizite zyrtare në Hungari, të mërkurën ka takuar kryetarin e Parlamentit të Hungarisë, Laszlo Kover. Në platformën sociale “Facebook”, Osmani ka potencuar se Kosova është e vendosur të çelë kapituj të ri të bashkëpunimit me Hungarinë, në të njëjtën kohë t’i ruajë raportet

historike dhe t’i fuqizojë lidhjet në mes të dy popujve. “Gjatë takimit diskutuam edhe për rëndësinë e bashkëpunimit ndërshtetëror në përfitim të qytetarëve të të dyja vendeve”, ka shkruar Osmani. Gjatë qëndrimit në Hungari, Osmani takoi edhe presidentin hungarez Tamas Sulyok, ku e para e shtetit e vlerësoi të madh

potencialin për rritjen e mëtejme të bashkëpunimit Kosovë - Hungari. “Në takim i shpreha presidentit Sulyok mirënjohjen e qytetarëve të Kosovës për rolin e Hungarisë në kuadër të KFOR-it, për mbështetjen e dhënë studentëve të Kosovës ndër vite, si dhe për iniciativat që kanë afruar edhe më shumë dy vendet tona”, shkroi Osmani në “Facebook”.

MBI 37 MIJË BANORË REZIDENTË E LËSHUAN KOSOVËN NË VITIN 2024

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar vlerësimin e popullsisë për vitin 2024. Sipas vlerësimit, gjatë vitit 2024 popullsia e Kosovës pati një rritje natyrore prej 10 888 banorësh. Vendbanimin (komunën) e tyre e ndërruan 21 513 banorë, kurse imigruan në Kosovë 9 038 banorë, derisa emigruan 37 451 banorë.

Bilanci i migrimit ndërkombëtar (migrimi neto) për vitin 2024 ishte -28 413 banorë, ndërkaq popullsia rezidente e Kosovës në vitin 2024 u zvogëlua për 17 525 banorë. Popullsia e vlerësuar e Kosovës në vitin 2024 ishte 1 585 590 banorë rezidentë. Të dhënat vjetore statistikore për popullsinë (demografinë) janë themelore për studimin dhe përcaktimin e një game të gjerë analizash. Ato përbëjnë komponentin thelbësor për vlerësimin e llogarive kombëtare, punësimit dhe çështjeve të tjera socio-ekonomike. Vlerësimi i numrit të popullsisë është domosdoshmëri, praktikë dhe standard që kërkohet të bëhet çdo vit nga institucionet zyrtare të statistikave të një vendi, për faktin se në periudhën ndërmjet dy regjistrimeve të popullsisë (periudhë dhjetëvjeçare) ndodhin ndryshime të theksuara në popullsinë e një vendi.

FSK-ja, STËRVITJE TË PËRBASHKËT ME USHTARËT E IOWAS

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Forca e Sigurisë së Kosovës së bashku me Ushtarët e Gardës Kombëtare të Ushtrisë së Iowas dhe njësi mbështetëse të specializuara po marrin pjesë në një stërvitje ushtarake në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo stërvitje po zhvillohet në kushte të intensitetit të lartë dhe për simulime luftarake të avancuara, thuhet në njoftimin e lëshuar nga Garda Kombëtare e Iowas. Aty thuhet se të gjitha njësitë po përballen me mjedis sfidues dhe presion të lartë, i projektuar për të reaguar në luftime në shkallë të gjerë.

Për ushtrimin në fjalë ka folur edhe ministri në detyrë i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci. Ky ushtrim, sipas tij, ofron një mjedis të vështirë dhe realist për ta vlerësuar aftësinë e brigadës për t’u vendosur, luftuar dhe fituar kundër një kërcënimi pothuajse të barabartë. “Pjesëtarët pjesëmarrës në këtë ngjarje kritike stërvitore testojnë gatishmërinë dhe efektivitetin e armëve luftarake, logjistikës, mjekësisë, inxhinierisë dhe njërive të avionit në një mjedis operacionesh luftarake në shkallë të gjerë”, ka shkruar Maqedonci në “Facebook”.

Sveçla zhvillon vizitë zyrtare në Kroaci, diskutohet thellimi i bashkëpunimit në fushën e sigurisë

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Ministri në detyrë i Punëve të Brendshme të Kosovës, Xhelal Sveçla, po qëndron për vizitë zyrtare në Kroaci. Ai është pritur me nderime nga homologu kroat dhe zëvendëskryeministër Davor Bozinoviç. Në njoftimin e Ambasadës së Kroacisë në Kroaci thuhet se gjatë takimit ata diskutuan për sfidat e përbashkëta të sigurisë dhe theksuan nevojën për bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve në kuadër të vlerave të përbashkëta euroatlantike. “Të dy ministrat riafirmuan marrëdhëniet e shkëlqyera ndërmjet dy vendeve, veçanërisht në fushën e sigurisë, duke theksuar përkushtimin për thellimin e mëtejme të bashkëpunimit, në frymën e partneritetit dhe vlerave të përbashkëta euroatlantike”, thuhet në njoftim.

Ata vlerësuan kontributin e përbashkët për stabilitetin në Ballkanin Perëndimor dhe rolin e ministrive përkatëse në garantimin e paqes. Vizita e Sveçlës në Zagreb po zhvillohet në kuadër të Ministerialit të Forumit të Salzburgut, që këtë vit mbahet në Kroaci, si platformë për bashkëpunim rajonal ndaj sfidave si migrimi, ekstremizmi dhe krimi i organizuar.

SWISSCONTACT NË KOSOVË DISKUTON PARTNERITETIN PËR NJË TË ARDHME TË QËNDRUESHME NË SEKTORIN E PËRPUNIMIT TË USHQIMIT

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Ekspertë, përfaqësues të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, si dhe aktorë kyçë të sektorit të ushqimit në Kosovë, u mbledhën në konferencën “Zhvillimi i Sektorit të Ushqimit në Kosovë - arritjet dhe rruga përpara”, organizuar nga Swisscontact përmes projektit Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat (PPSE), mbështetur nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë. Konferenca u zhvillua në një moment kyç për sektorin e përpunimit të ushqimit në vend për t’i vlerësuar arritjet e deritanishme dhe të përcaktohet drejtimi për zhvillim të mëtejshëm, të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës. Në fjalën hyrëse, sekretarja e përgjithshme në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Venera Çerkini, tha se sektori i bujqësisë është

një shtyllë e rëndësishme e zhvillimit ekonomik në vend. “Sektori i bujqësisë dhe ushqimi mbeten një nga shtyllat më të rëndësishme të zhvillimit ekonomik të vendit tonë. Ky sektor jo vetëm që siguron ushqim për qytetarët tanë, por mban gjallë zonat rurale dhe ofron mundësi të qëndrueshme punësimi për mijëra familje në Kosovë”, ka potencuar Çerkini. Kurse Jean-Christophe Favre nga Ambasada e Zvicrës në Kosovë tha se mbështetja e Zvicrës përmes projektit PPSE ka hapur rrugë të reja të bashkëpunimit mes fermerëve, grumbulluesve, prodhuesve dhe sektorit të shitjes me pakicë, duke e zhvilluar këtë sektor në nivel konkurrues në rajon. Ndërkaq drejtori i Swisscontact në Kosovë, Fisnik Reçica, ka falënderuar partnerët e projektit. Sipas tij, PPSE dëshmon se ndryshimi sistemor në Kosovë është i mundur kur



krijohet pronësi dhe kapacitetet i qëndrueshëm të aktorët e tregut. Ndërsa hollësitë e punës 12-vjeçare të projektit PPSE në sektorin e përpunimit të ushqimit u paraqitën nga Avni

Ramadani dhe Diana Rexhepi. “Synimi ynë ishte që bashkërisht me aktorët e sektorit dhe me një qasje gjithëpërfshirëse të angazhohemi për përmirësimin e konkurrueshmërisë, përmirësimin dhe diversifikimin e

ofertës si dhe përmirësimin e qasjes në tregje”, ka theksuar Ramadani. Diana Rexhepi ka pohuar se rezultatet treguan ndikimin e intervenimeve sistemike dhe inovative në sektor. “Qasja jonë me prodhuesit vendorë ka qenë angazhimi i përbashkët për ngritjen e kapaciteteve teknologjike, forcimin e njohurive, avancimi dhe inovacioni, prandaj është parë edhe një mundësi më e mirë jo vetëm për zhvillimin e produkteve të reja, por për ta shtuar vlerën e produkteve”, ka theksuar Rexhepi. Diskutimi pasues solli shembuj konkretë nga terreni përmes ndërmarrjeve të përkushtuara si Agro Celina, Bliff Organic, Liostep dhe Ananas Impex, që ndan përvojat e tyre për përpunimin e ushqimit, sfidat drejt certifikimit organik dhe rritjes së kapaciteteve të eksportit.

KATËR SHPELLAT UNIKE TË KOSOVËS NË PULLA POSTARE

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Posta e Kosovës, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, përkatësisht me Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, lansoi të mërkurën emisionin më të ri të pullave postare kushtuar katër prej monumenteve natyrore më të veçanta të vendit: Shpella e Kusarit, Shpella “Gryka e Madhe”, Shpella e Hoxhës dhe Shpella e Demës. Ky emision paraqet një udhëtim vizual të pasur nëpër thesaret nëntokësore të vendit tonë - dëshmi të rralla të gjeologjisë, arkeologjisë, biodiversitetit dhe historisë sonë të lashtë. Përmes këtyre pullave publiku ka mundësinë t’i njohë vlerat e jashtëzakonshme natyrore dhe kulturore që i ofron Kosova.



Shpella e Kusarit gjendet pranë fshatit të lashtë Kusar në rajonin e Gjakovës. Është pjesë e peizazhit karstik të Malit Pashtrik. E formuar në shkëmbinj gëlqerorë me një histori mijëvjeçare, shpella mbart gjurmë të banimit të hershëm dhe ofron një ambient unik për studiuesit dhe vizitorët.



Shpella “Gryka e Madhe”, e pozicionuar në kilometrin e tetë të Grykës së Rugovës, 60 metra mbi shtratin e Lumëbardhit të Pejës, ofron një pamje imponuese që i ngjan një tempulli natyror. Brenda saj gjenden stalaktite dhe stalagmite të mahnitshme, lumenj e liqene nëntokësore, duke e renditur këtë shpellë

ndër më të mëdhatë në Kosovë dhe rajon për nga vlera speleologjike dhe turistike. Shpella e Hoxhës, mbi fshatin Vrellë të Istogut, në masivin malor të Mognës, përfaqëson një lokalitet arkeologjik me rëndësi të madhe. Ajo ka qenë e banuar që nga parahistoria e deri në kohët moderne. Brendësia e saj ruan

fragmente qeramike, gurë të punuar dhe një liqen të brendshëm, që formohet nga pikimi i vazhdueshëm i stalaktiteve. Shpella e Demës, e cila ndodhet në hyrje të Grykës së Rugovës, pranë Patrikanës së Pejës, shquhet për vlerat historike dhe biologjike. Si lokalitet arkeologjik, kjo shpellë simbolizon lidhjen e përhershme ndërmjet njeriut dhe natyrës, duke ruajtur gjurmë të qëndrueshmërisë njerëzore ndër shekuj. Përmes këtij emisioni të veçantë Posta e Kosovës synon ta promovojë dhe të nxisë vetëdijen për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të Kosovës. Pullat postare shërbejnë jo vetëm si mjete komunikimi, por edhe si ambasadore të vlerave tona kombëtare në botë.

Ofrohet qasje e lehtë në kredi bujqësore përmes digjitalizimit dhe eliminimit të barrierave

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Ministri në detyrë i Bujqësisë, Faton Peci, ka thënë se qasja në financa dhe mundësia e kreditimit të favorshëm në bujqësi është hallka e radhës në zinxhirin e punëve të mira që janë realizuar vitet e fundit në Ministrinë e Bujqësisë. “Me legjislationin që kemi hartuar

për faturat e produkteve bujqësore dhe partneritetin me IFC - International Finance Corporation kemi mundësuar qasje kreditore për fermerët me norma të favorshme të interesit. Përpos mbështetjes që kemi ofruar për fermerët nga skemat financiare të Ministrisë, projekti që po lansohet sot është edhe

një mundësi për akses më të lehtë në financa dhe do të mundësojë përdorimin e produkteve bujqësore dhe mallrave të magazinuara si kolateral për financim. Tani ka akses i lehtë në kredi bujqësore përmes digjitalizimit dhe eliminimit të barrierave”, ka thënë Peci.



MBI RUBIKONIN E LINDJES SË MESME

Gianni RIOTTA

Presidenti Donald Trump është i vetëm. Gjashtë muaj pas fitores historike në Uashington, sheh aleatët e vjetër të Atlantikut dhe Paqësorit të largohen, miqtë mbi të cilët mbështetej të tërhiqen, udhëheqësin rus Putin të shurdhët ndaj thirrjeve të tij dhe kryeministrin izraelit Netanyahu të bindur se mund ta shtyjë drejt një ofensive, me argumenta që vetëm pjesërisht qëndrojnë; Kina e Xi Jinping nuk lëshon as edhe një pëllëmbë për tarifën; luftërat në Ukrainë, Gaza dhe tani, apokalipsi i mundshëm midis Izraelit dhe Iranit. Trump e kërkonte vetminë si zgjedhje strategjike, i bindur se Fortesa Amerikë është në gjendje të imponojë hegjemoni planetare, pas dështimit të iluzioneve për OKB-në, G7-ën, marrëveshjet diplomatike – dhe tani e gjen veten i vetmuar përballë një udhëkryqi historik. E kishte ëndërruar një vetmi të ndritur, “imperiale” sipas shprehjes së historianit Arthur Schlesinger, dhe në vend të kësaj po ndeshet me një botë që nuk e kupton, plot me miq dyshues, aleatë të paqartë dhe armiq të alarmuar.

I bindur se do ta bindte Moskën të negocionte me një president ukrainas të përulur dhe Izraelin të pranonte statusin e fitimtarit me Gazën të mundur, Trumpi nuk mundi ta ndalonte Netanyahu-n të godiste nga ajri Teheranin dhe bazën atomike të Fordos, duke shkaktuar masakra mes gjeneralëve, shkencëtarëve dhe civilëve iranianë: pak javë më parë, Tulsi Gabbard, kreu i shërbimeve të inteligjencës amerikane, kishte kundërshtuar Jeruzalemin në lidhje me kohën që i duhej ende regjimit të ajatollahëve për armën bërthamore, duke deklaruar se ajo është ende larg dhe ka ka mundësi për zgjidhje diplomatike.

Duke luajtur me vetminë e presidentit, Netanyahu, politikan që nuk heziton të hedhë zarin në Rubikonin e Lindjes së Mesme, ka zgjedhur luftën, një nga konfliktet me gjatësi të paparashikueshme që nga shtatori i 2001-it, të cilin lëvizja MAGA e dënonte si trashëgimi të Bushit dhe Bidenit. Duke u larguar me nxitim nga G7-a e Kanadasë, siç kishte bërë edhe në 2018-ën i tërbuar me kryeministrin Trudeau, Trumpi i heq vërejtje presidentit francez Macron, përhap idenë se diçka e rëndë është pranë, madje evokon edhe fantazinë e Putinit si ndërmjetës mes palëve, për t’u gjetur sërish i vetëm, me bazën e tij elektorale të hutuar përballë pamjeve të bombardimeve. Partia republikane është e ndarë: në njërën anë janë skifterët pro-izraelitë, si senatori Graham, dhe në tjetrën neutralët si zëvendëspresidenti Vance. Zërin e republikanëve të




zhgënjyer e përfaqëson komentatori i njohur Tucker Carlson, i cili në buletin e tij të ndjekur nga miliona lexues, akuzon presidentin për “bashkëpunim me luftën e Netanyahu-t”, i detyruar nga një grusht luftënxitësish për t’u imponuar veten... “më mirë një izraelit se një amerikan që sillet si ai,” thotë, ndërsa ish-miku Donald ironizon: “Do ishte mirë që Tucker të gjente ndonjë punë, ndoshta në televizion”. Përçmimi nuk zgjidh dilemën, as obsesioni për “paqen e menjëhershme” apo “armëpushimi për 24 orë”, që u zhdukën pas nëntorit, dhe vetmia e presidentit ka tani një shoqërues të frikshëm në vetmi, prania e të cilit, nënvizon me ironi Carlson, “do të përkufizojë mandatin e dytë të administratës Trump”. Në planet e Trump-it, në fakt, qëndron pezull një bombë e quajtur Massive Ordnance Penetrator, GBU-57, 30.000 paund shkatërrimtare që lëshohet nga bombarduesit

amerikanë B-2 – një armë që arsenalit izraelit nuk e zotëron – e vetmja në gjendje të depërtojë bunkerët nëntokësorë të bazës atomike të Fordos. Ai mund të urdhërojë përdorimin e saj, ndoshta me më shumë sulme të sinkronizuara për të njëjtin objekt, dhe të mbyllë projektin atomik të ajatollahëve, me koston e përfshirjes së Shteteve të Bashkuara në një përplasje aq të madhe, sa do të zgjaste konfliktin shumë më tepër se një gjeneratë, si në Afganistan e Irak. Susie Wiles, shefja e gjithëpushtetshme e kabinetit të Shtëpisë së Bardhë, i qorton çdo ditë ministrat, këshilltarët, zyrtarët: “Mos harroni, virtyti më i rëndësishëm është besnikëria ndaj Presidentit Trump. Të gjitha të tjerat janë dytësore”. Në një klimë ku rangi i një armiku vlerësohet në mënyrë tepër të kufizuar përmes opinionëve të brendshme, Washingtoni ndjek skenare të shpeshta lufte, si në romanin e tij të preferuar “Lamtumirë armë”, të

Hemingway-t, i vitit 1929. Urdhri përfundimtar i takon presidentit, njeri i vetëm në komandë, dhe si çdo vendim tjetër – që nga hyrja në politikë nga 5th Avenue në Nju Jork, në 16 qershorin e shumëpërfolur – do të diktohet nga instinkti, nga humori i çastit. Një rrezik që shqetëson miq e armiq, por që Trump e ndjek verbërisht, me bindjen e një sipërmarrësi nga New York-u e cila e ka çuar, dy herë, në Shtëpinë e Bardhë. Nga liberalizmi tregtar te tarifën, nga përplasjet me Harvard-in, bllokimi i emigracionit, kufizimet për kërkimin shkencor, konfuzion mbi mjedisin dhe familjen – ai bën atë që ligji nuk ia ndalon, por që asnjë, më parë, nuk ka guxuar ta bëjë. Ai nuk ndjek një rutinë lufte, siç e përshkruan Hans Delbrück në veprën e tij monumentale “Historia e Artit të Luftës”, kur flet për vendimet e Napoleonit në Marengo 1800: “Shpesh ai vendoste në kundërshtim me

gjithçka, pa ndonjë justifikim – përveç se i dukej momenti i duhur”. Kështu edhe Trump, do të vendosë vetëm, larg qytetarëve, Tel Avivit, Teheranit, dhe ligjeve. Ndërkohë, të gjithë presin me ankth nëse kjo çështje do të arrijë në “dorëzimin pa kushte” të iranianëve, me sinjale të pakta për negociatë dhe dyshime të mëdha përmes liderëve evropianë e të Kombeve të Bashkuara. Në Shtëpinë e Bardhë, ministri i Mbrojtjes Lloyd Austin, dhe këshilltari për sigurinë Jake Sullivan, pëshpëritin shprehjen e famshme “Unknown Unknowns” – “të panjohurat e panjohura” – një mënyrë për të thënë se askush nuk e di saktësisht se çfarë mund të ndodhë më tej, dhe se çmimi për një strategji të tillë të pakontrolluar dhe të vetmuar mund të jetë shumë i kushtueshëm për Amerikën. / La Repubblica – Bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Ballkani mëson kundërshtarët për kualifikimet e Ligës së Konferencës

Nënkampioni i Kosovës në futboll, Ballkani, ka mësuar kundërshtarët e mundshëm për kualifikimet e garës evropiane UEFA Conference

League. Skuadra nga Suhareka nis garat nga rrethi i dytë kualifikues. Shorti do të vendosë nëse Ballkani do të luajë me njërën nga këto

skuadra: NK Varazdin nga Kroacia, FC UNA Strassen nga Luksemburgu, apo njërin prej fitueseve të këtyre ndeshjeve: La Fiorita 1967 (San Marino) -

FC Vardar (Shkup), Floriana FC (Maltë) - Havefordwest (Uells) dhe ST Joseph's (Gjibraltari) - Cliftonville (Irlandë e Veriut). Ballkani ka

qenë pjesëmarrës i kësaj gare tri herë duke luajtur në dy periudha edhe në fazën e grupeve si skuadra e vetme e Kosovës.

Ademi: Bisedë e frytshme me Fodën për të ardhmen e Kosovës



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, është takuar sot në Austri me përzgjedhësin Franco Foda, i cili është lidhur me një largim nga "dardanët" dhe transferimin në Arabinë Saudite. Ademi e ka quajtur bisedën të frytshme, por nuk ka dhënë hollësi tjera lidhur me të ardhmen e Fodas. "Sot në Vjenë, një kafe dhe një bisedë e frytshme për të ardhmen e

Kombëtares me përzgjedhësin Franco Foda!", ka shkruar Ademi.

Në anën tjetër në Arabinë Saudite po rritet bindja se trajneri gjerman do të jetë trajneri i ri i Al Wahdas. Klubi nga Emiratet e Bashkuara ka shtuar kontaktet me përzgjedhësin aktual të Kosovës dhe, sipas raportimeve nga media arabe, marrëveshja është pranë finalizimit. Gazetari i njohur Ahmed Ragab ka shkruar se klubi Al Wehda është shumë pranë emërimit të gjermanit Franco Foda trajneri i

ri i skuadrës. Foda ka kontratë me "dardanët" deri në përfundim të kualifikimeve për Botërorin 2026m, të cilën e kishte konfirmuar edhe presidenti i FFK-së ditë më parë. "Foda aktualisht ka obligime kontraktuale me ne dhe presim që ato obligime të përmbushen, veçanërisht tani, në këtë fazë të rëndësishme të fushatës kualifikuese për Kampionatin Botëror, drejt së cilës shkojmë me optimizëm dhe dëshirë të madhe për sukses", kishte deklaruar Ademi.

SHKURT

Edicioni i ri i garave në Superligë fillon më 16 gusht

Edicioni i ri 2025/26 në futbollin e Kosovës do të nisë në fundjavën e 16/17 gushtit. Të parat që nisin garat do të jenë dy nivelet më të larta, Albi Mall Superliga dhe Raiffeisen Liga e Parë e Kosovës. Pjesë e elitës së futbollit sivjet do të jenë Prishtina e Re dhe Drenica, të cilat ishin kampione në grupet e tyre respektive në Ligën e Parë. Të rikujtojmë se Liga e Parë në këtë edicion do të funksionojë si ligë unike, me 18 skuadra.

Hull City interesohet për Hoxhën

Arbër Hoxha është një nga emrat më të përfolur në merkato këtë verë. Sulmuesi kuqezi pritet të largohet nga Dinamo Zagreb dhe të nisë një aventurë të re në karrierën e tij. Sipas medieve britanike, një prej destinacioneve më të mundshme është Hull City, skuadra që militon në Championship. Interesimi i anglezëve për Hoxhën lidhet edhe me trajnerin e ri të ekipit, Sergej Jakiroviq, i cili e ka stërvitur sulmuesin shqiptar gjatë kohës së tij në Dinamo Zagreb dhe e njeh mirë potencialin e tij. Në ditët në vijim pritet një ofertë zyrtare nga klubi anglez. Por Hull City nuk është i vetmi në garë për shërbimet e 25-vjeçarit. Edhe Lecce nga Seria A italiane dhe Kayserispor nga Superliga turke kanë shprehur interesim për Hoxhën, i cili duket i vendosur për ta bërë hapin e radhës në karrierë. Vendimi përfundimtar pritet të merret brenda pak javësh.

Katër klube italiane në garë për Ismajlin

Krahas Lazios, në garë për Ardian Ismajlin janë futur edhe tri skuadra nga Seria A e Italisë, Parma, Verona e Cremonese. Ismajlit në fund të këtij muaji i skadon kontrata me Empolin dhe shumë klube janë në garë për shërbimet e tij, pasi duan ta transferojnë si lojtar të lirë. Po ashtu, Ismajli po shqyrton edhe mundësinë e kalimit në Turqi, ku Beshiktashi e Trabzonspori tashmë e kanë kontaktuar. 28-vjeçari sezonin e fundit ishte ndër mbrojtësit më të vlerësuar në Itali dhe në disa prej ndeshjeve të Empolit, barti edhe shiritin e kapitenit. Ai bën karrierë në Serinë A prej vitit 2020, ku para se t'i bashkohej Empolit në vitin 2021, një sezon barti edhe fanellën e Spezias.

Trepça në kualifikimet e Ligës së Kampionëve

MITROVICË, 18 QERSHOR - Bordi i Ligës së Kampionëve të Basketbollit ka miratuar garat për edicionin e ri. Kampionia e Kosovës, Trepça, do të jetë në kualifikimet e kësaj gare. 29 skuadra tashmë janë konfirmuar, ndërsa për tri vende do të garojnë 24 skuadra. 24 klubet që do të garojnë në raundin

kualifikues do të shorthohen në tre turne, ku fituesi i secilit turne do të avancojë në Edicionin e Rregullt. Turnetë e Raundit Kualifikues do të zhvillohen nga 23 deri më 28 shtator, ndërsa Edicioni i Rregullt do të fillojë më 7 tetor 2025. Ceremonia e shortit për grupet e edicionit të rregullt dhe turnetë e

Raundit Kualifikues do të zhvillohet në Lozanë të Zvicrës të mërkurën më 2 korrik. Trepça edicionin e kaluar ishte në kualifikimet e Ligës së Kampionëve, ndërsa më pas pjesë e grupeve të FIBA Europe Cup. Mitrovicasit fituan titullin, Kupën dhe Superkupën në edicionin e kaluar.



Malisheva përforcohet me Xhemajl Ibishin

MALISHEVË, 18 QERSHOR - Skuadra e Malishevës që në raundin e parë të Ligës së Konferencës do të përballet me Vikingur Reykjavik nga Islanda, sot është përforcuar me një sulmues. Bëhet fjalë për Xhemajl Ibishin, i cili vjen në “Liman Gegaj” nga FC Shkupi.

“FC Malisheva ka kënaqësinë t’ju prezantoj sulmuesin Xhemajl Ibishin si përforcimin e parë të këtij afati kalimtar. Sulmuesi ynë i ri ishte një nga më të mirët me FC Shkupi në Maqedoni të Veriut, ndërsa vjen te ne për të qenë vlerë e shtuar në skuadrën tonë për

garat evropiane dhe për edicionin e ri në Albi Mall Superligë. Ibishi njihet për cilësitë e tij fizike dhe ‘vrasës’ para portës, andaj presim që me kualitetin e tij të na dhuroi spektakël, shumë gola dhe asistime! Ne jemi të fokusuar të vazhdojmë t’i rrisim vlerat dhe

konkurrueshmërinë përbrenda skuadrës sonë, për të qenë sa më të gatshëm për sfidat që na presin dhe realizimin e objektivave në të gjitha drejtimit. Mezi presim të shohim në fushë, Xhemajl!”, thuhet në njoftimin e Malishevës.



Milani ofron 10 milionë euro për Xhakën, Leverkuseni kërkon 15 milionë

MILANO, 18 QERSHOR - Granit Xhaka po vazhdon të mbetet një nga objektivat kryesore të AC Milan në këtë afat kalimtar. Kapiteni i Zvicrës po konsiderohet lojtar që do t’i përshtatej perfekt stilit të lojës së Massimiliano Allegrit dhe për këtë arsye “rossonerët” janë duke i bërë trysni Bayer Leverkusenit. Mediet gjermane raportojnë se drejtori i ri sportiv, Igli Tare, ka shkuar personalisht në Gjermani për t’u takuar me drejtuesit e “farmaceutikëve”. Derisa e përditshmja italiane “La Gazzetta dello Sport” raporton se Milani ia ka ofruar Leverkusenit 10 milionë euro për kartonin e ish-futbollistit të Baselit, Borussia Monchengladbachut e Arsenalit. Por, duket se kjo shumë nuk është e mjaftueshme për ish-kampionët e Gjermanisë, të cilët mund t’i kërkojnë deri në 15 milionë euro. Ose kërkesë e



Leverkusenit, është mbrojtësi Malick Thiaw, një profil i vlerësuar lart nga trajneri i ri, Erik ten Hag, por të cilin duket se nuk dëshiron ta lëshojë trajneri Allegri. Xhaka, nga ana e tij, e ka shprehur gatishmërinë për të lëvizur drejt Serisë A pas përvijës së jashtëzakonshme me Leverkusenin, të cilit këtë

verë duket se do t’i ikin krejt yjet, krahas trajnerit Xabi Alonso. Në sezonin 2024/25, 32-vjeçari i ka zhvilluar 49 ndeshje, ndërsa i ka realizuar 2 gola dhe i ka bërë 7 asistime. Vlera e kartonit të Xhakës në treg, sipas faqes së specializuar për vlerësimin e lojtarëve, “Transfermarkt”, është 12 milionë euro.

Groves: Joshua dhe Fury do të duelojnë mes tyre, po presin ofertën e duhur për t’u ngjitur në ring

LONDËR, 18 QERSHOR - Nëse Anthony Joshua dhe Tyson Fury do të duelojnë sërish në ring, ata duhet të boksojnë njëri-tjetrin. Kështu është shprehur ish-kampioni i botës George Groves. Joshua nuk ka boksuar që nga shtatori i vitit të kaluar, kur u mund nga Daniel Dubois. Vitin e kaluar, Fury humbi dy duelet ndaj Oleksandr Usyk dhe njoftoi tërheqjen e tij nga sporti në janar. Megjithatë, ai ka publikuar rregullisht pamjet e stërvitjes së tij, gjë që ka nxitur spekulime për një rikthim të mundshëm. Duke qenë se Usyk dhe Dubois janë të zënë me revanshin mes tyre, për Fury dhe Joshua nuk ka alternativë tjetër veçse të duelojnë mes tyre. “Nëse do të isha si ata thjesht do të përballeshim me njëri-tjetrin dhe kjo është e gjitha”, ka thënë



Groves. “Nuk do të shqetësohesha për asnjë përballje me rival tjetër. Jam i sigurt se paratë që ofron kjo sfidë janë të shkëlqyera. Të dy janë mposhtur së fundi, ndaj thjesht boksoni me njëri-tjetrin edhe për fansat britanikë”, ka shtuar George Groves.

Më tej ai ka shtuar: “Duhet të ketë një shumë financiare që e bën të vlefshëm atë sfidë për të dy djemtë. Ndoshta ata thjesht janë duke pritur për atë numër. Nuk kanë nevojë ta shpallin atë përballje që tani nëse nuk do të ndodhë deri në tetor”.

SHKURT

Ramos: Mbappe meriton ‘Topin e Artë’

Ish-kapiteni i Real Madridit, Sergio Ramos, aktualisht futbollist i Monterreyt në Meksikë, foli për “Topin e Artë”. Ai tha se këtë trofe individual e meriton Kylian Mbappe. “Gjithmonë do t’ia jepja Mbappes. Jo vetëm sepse jemi miq, por edhe për atë që ka treguar në fushë. Ai ka shënuar shumë, fitoi Këpucën e Artë, ishte vendimtar edhe pse skuadra e tij nuk fitoi gjithçka”. Për ish-kapitenin e Real Madridit, Mbappe tashmë ka atë që duhet për të bërë histori: “Nëse do të varej nga unë, sot ai do të kishte tashmë 4 ose 5 ‘Topa të Artë’ në kabinetin e tij. Ai ka gjithçka: talent, qëndrueshmëri, shpirt konkurrues. Ai është një kampion që vetëm mund të përmirësohet”.

Barcelona konfirmon transferimin e portierit Joan Garcia

Skuadra e Barcelonës ka konfirmuar zyrtarisht nënshkrimin e portierit Joan Garcia nga rivali i urryer lokal, Espanyoli. Klubi nga “Camp Nou” ka kompletuar tashmë transferimin e parë të verës. Bëhet fjalë për portierin e talentuar spanjoll, Joan Garcia, i cili vjen nga Espanyoli për një shifër prej 25 milionë eurosh. Garcia do të paraqitet të premtën nga Barcelona dhe do të nënshkruajë një kontratë gjashtëvjeçare. “FC Barcelona aktivizoi klauzolën e lirit të lojtarit Joan Garcia. Kostoja e klauzolës ishte 25 milionë euro. Këtë të premtë lojtari do të nënshkruajë një kontratë me klubin për gjashtë sezonet e ardhshme, deri më 30 qershor 2031, në një ceremoni private në zyrat e FC Barcelona”, thuhet në njoftim e Barçës.

Nga podiumi i parë në Formula 1 në provimin e maturës, talenti i Mercedesit: Nuk ka privilegje

Është periudhë provimesh për Kimi Antonellin, pilotin 18-vjeçar të Mercedesit, që në garën e fundit të Formulës 1 zhvilluar në Montreal, korri podiumin e parë në karrierë. Jo vetëm kaq, por për herë të parë pas 16 vjetësh një pilot italian u ngjiti në podium. Por tashmë për Antonellin nis një tjetër “test” i vështirë, ai i provimeve të maturës. Ai ndjek me sukses Institutin “Gaetano Salvemini” në Casalecchio di Reno, një nga komunat më të populluara në periferi të Bolonjës. Dhe, ashtu si shokët e klasës, këtë javë do ta ketë testin e parë me shkrim. “Nëse do të diplomohem do të duhet të bëj provimin e pjekurisë. Si gjithë të tjerët, nuk ka asnjë privilegj që jam pilot i Formulës 1”, ka thënë Kimi Antonelli. “Kam bërë sakrifica, por kam komunikuar edhe me shokët e klasës. Këto do të jenë kujtime që do të mbeten gjithmonë”, ka shtuar Antonelli, që ka një mesatare të mirë, mbi 8 çdo vit. Pjesëmarrja ka qenë konstante, brenda kufijve të angazhimeve të tij sportive.

Pas De Bruyne, Napoli kërkon edhe dyshen Nunez - Sancho

Napoli pas zyrtarizimit të Kevin De Bruyne nuk ka ndër mend të ndalet, teksa tashmë ka hedhur sytë nga dy emra të tjerë të mëdhenj të Premierë Ligës: Darwin Nunez dhe Jadon Sancho. Sipas asaj që raporton e

përditshmja “Repubblica”, të dy lojtarët kanë dhënë një miratim paraprak për projektin ambicioz të klubit napolitan. Tani topi është në fushën e klubeve përkatëse, me tratativat që pritet të hyjnë në fazën vendimtare

gjatë javëve në vijim. Një element kyç në këtë operacion mund të jetë shitja e Victor Osimhen, sulmues nigerian që ka shumë kërkesa nga klubet e mëdha angleze. Largimi i tij jo vetëm që do të hapte vend në

repartin ofensivë, por edhe do të sillte të ardhura të konsiderueshme për ta përforcuar më tej skuadrën. Me ardhjen e De Bruynes, synimet për Darwinin dhe Sanchon dhe me një projekt të drejtuar nga

drejtori sportiv, Giovanni Manna, Napoli duket më i vendosur se kurrë për të ndërtuar një skuadër që të rivalizojë për titullin dhe të rikthehet fuqishëm në skenën evropiane.



Rr"Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpinë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegjbiznesi.com,

Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878 info@kolegjbiznesi.com

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: 30.05.2025, të Kolegjit "BIZNESI" Prishtinë dhe Dega në Prizren:

Kolegji Biznesi shpall konkursin publik të regullt për pranimin dhe regjistrimin e studentëve të rinj për vitin akademik 2025/2026, në të gjitha programet e studimit të akredituara nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës dhe të licencuara nga MASHT.

Të drejtë aplikimi dhe regjistrimi në studimet themelore (Bachelor) e kanë të gjithë kandidatët që e kanë përfunduar shkollimin e mesëm të lartë dhe që e kanë përfunduar me sukses testin korrobëtor të maturës. Kurse në studimet Master kanë të drejtë aplikimi dhe regjistrimi të gjithë kandidatët që i kanë përfunduar Studimet Bachelor.

Studime Bachelor

- 1.Banka dhe Financa në Biznes (Ba) - (3 Vjeçar)
- 2.Menaxhment dhe Ekonomiks (Ba) - (3 Vjeçar)
- 3.Menaxhimi i Emergjencave (Ba) - (3 Vjeçar)
- 4.Juridik / LLB - (4 Vjeçar)
5. Shkencë Kompjuterike Bsc - (3 Vjeçar)

Studime Master

- 1.Menaxhment dhe Financa – MA-(2 Vjeçar)
- 2.Menaxhimi i Emergjencave – MA-(2 Vjeçar)

Studentët të cilët aplikojnë në studimet Bachelor, i bashkëngjisin aplikacionit:

- Certifikata e maturës shtetërore – origjinale ose kopje e notuar;
- Diploma e shkollës së mesme – origjinale ose kopje e notuar;
- Dëftesat e shkollës së mesme – origjinale ose kopje e notuar;
- Ekstrakti i lindjes;
- Kopje e letërnjoftimit;
- 2 foto grafi (formati pasaportë)

Studentët të cilët aplikojnë në studimet Master, i bashkëngjisin aplikacionit:

- Diplomën ose certifikatën e fakultetit (të notuar)
- CV
- Certifikatën e lindjes
- Kopjen e letërnjoftimit
- Dy foto

038/045- 500 878 : 029-230-555
044/ 049/ 048- 500 – 878



Rr"Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpinë 10000 Prishtinë –

Kosovë, www.kolegjbiznesi.com, info@kolegjbiznesi.com

Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: 30.05.2025, të Kolegjit "BIZNESI" Prishtinë:

SHPALL KONKURS PËR PRANIMIN E STAFIT AKADEMIK

I. PROFESORA

1. Dy (2) mësimdhënës në programin – **Ekonomik**,
2. Dy (2) mësimdhënës në programin – **Juridik**,
3. Dy (2) mësimdhënës në programin – **Menaxhimi i Emergjencave**,
4. Një (1) mësimdhënës në programin – **Shkencë Kompjuterike**,

Zgjedhja e personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Statutit të Kolegjit Biznesi.

Për vendin e punës mësimdhënës, kandidatët e interesuar duhet të kenë të përfunduar doktoratën në lëmin përkatës dhe punime në revistat si SCOPUS dhe WEB OF SCIENCE.

Njoftja e gjuhës angleze apo e ndonjë gjuhë tjetër të huaj është përparësi për aplikantët.

Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet të paraqesin këto dokumente: Kërkesën me biografi (CV), Kopjen e diplomës përkatëse të notuar (vërtetuar), Certifikatën e lindjes, Kopjen e letërnjoftimit.

Kandidatët që kanë doktoruar jashtë vendit duhet të sjellin edhe dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.

Konkursi mbetet i hapur nga **18.06.2025 deri më 30.06.2025**.

Paraqitja e dokumenteve: Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, 10000 Prishtinë, Kosovë ose përmes e-mail: info@kolegjbiznesi.com

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në web faqen: www.kolegjbiznesi.com

Aplikacionin mund ta shkarkoni në web faqen: www.kolegjbiznesi.com ose mund ta merri në zyrat e Kolegjit Biznesi.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Ariani Company" shpk, Vushtri, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Stacionin e karburanteve "Ariani Company" në Pestovë, Vushtri.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 05.08.2025 në ora 09:00, në objektin e Komunës së Vushtrisë, adresa Sheshi "Ahmet Krasniqi" nr.10 42000 Vushtri, do të organizohet debat publik nga Kompania "Ariani Company" shpk, Vushtri, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>

Meeting ID: 454 934 4495
Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Ariani Company" shpk, Vushtri, për Pëlqim Mjedisor, – për Stacionin e karburanteve "Ariani Company" në Pestovë, Vushtri.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Gresa Grezda shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Bedrush Avdija shpall të pavlefshme diplomën e sh.m Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Driton Morina shpall të pavlefshme dëftesën e sh.m.u "Rudolf Walther" Dejm Rahovec.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollëshme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

